Mësimi i misionit

Viti 1 – Tremujori 2

Lutu me siguri:
Lutemi për miqtë tanë në Amerikën latine

Qëllimi: Të theksojmë unitetin e kishës globale ndërsa i ftojmë nxënësit të luten për bashkëmoshatarët e tyre në shtetet e Amerikës latine.

Përmbledhja e mësimit: Nxënësit do të mësojnë për katër shtete në Amerikën latine. Secili prej këtyre shteteve ka kisha që përdorin programin Discovery Land, madje disa prej këtyre kishave kanë ndarë kërkesa lutjesh dhe foto me ne. Pasi të mësojmë më tepër për këto shtete, nxënësit do të marrin pjesë në një veprimtari ku do të luten për kërkesat e bëra nga këto kisha.

Shënime për drejtuesit:

1. Në këtë mësim misioni do të përfshijmë katër shtete në Amerikën latine dhe kishat që përdorin programin Zbuluesit atje. (Nëse keni kisha motra apo misionarë që mbështesni në këtë rajon, ju ftojmë t'i shtoni edhe ata te stacioni i lutjes në këtë veprimtari!)
2. Kishat që përdorin programin Zbuluesit janë një skuadër e madhe që sjellin shumë ndryshim. Si ndodh kjo? Një pjesë e pagesave që kishat në Amerikë japin për programin shkojnë për trajnimin e drejtuesve dhe përkthimin e kurrikulës në gjuhë të ndryshme.
3. Ne besojmë se lutjet e fëmijëve hapin dyert në fushën e misionit. Kur luteni për shtete specifike të listuara te mësimet, duhet të dini se ka edhe mijëra fëmijë të tjerë që po luten për ato shtete. Fëmijët tanë luten së bashku dhe Perëndia vepron në mënyra të fuqishme.



Materialet

- Hartë e botës
- Letra të shënuara me numra nga 1-4
- Tabak i madh për vizatim
    - Në letër tabak vizatoni një vijëzim të hartës së Amerikës latine (sa më të madhe të mundeni)
    - Ngjisni një yll prej letre te këto shtete: #1 Uruguai, #2 Kolumbi, #3 El Salvador, #4 Ekuador
    - Mundësi alternative: Përdorni një poster të madh për secilin prej shteteve dhe ngjiteni flamurin e shtetit në qendër. Lini hapësirë përreth kufijve të flamujve që nxënësit të vendosin emrat e tyre.





- Postera me foto të fëmijëve nga secili shtet (burim i printueshëm)
- Kartonë të mëdhenj me numrat 1-4 për secilin prej stacioneve të lutjes
- Postera me kërkesat e lutjeve për secilën vendndodhje (burim i printueshëm)
- Lapustila me ngjyra të ndryshme
- Kartonë të vegjël me pika lutjesh që nxënësit do t'i shkëmbejnë me njëri-tjetrin (nga një për çdo nxënës) (burim i printueshëm)
- Muzikë adhurimi që duhet të luhet kur nxënësit do të duhet të ndërrojnë stacion. Ide shtesë: Vendosni një këngë që ata e njohin, por në spanjisht e jo në shqip. Ja disa alternativa:

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- "Great Things" – https://www.youtube.com/watch?v=JYemaJCcH9U
- "One Way" – https://www.youtube.com/watch?v=xFIU6pGqslE
- "Nothing is Impossible" – https://www.youtube.com/watch?v=JskHuiSh1uA

Përgatitja e ambientit

- Vendosni vijëzimin e madh të Amerikës latine në qendër të dhomës.
  - Nxirr dhe markerat.
- Përreth ambientit cakto katër stacione (nga një për çdo shtet). Në secilin stacion:
  - Shfaq numrin që korrespondon me numrin e yjeve në hartë.
  - Shfaq posterin me kërkesat e lutjeve për atë shtet.
  - Shfaq posterin me fotot e fëmijëve nga ai shtet.
  - Vendos kartonë e vegjë që nxënësit do të shkëmbejnë me njëri-tjetrin.

Ide për ta bërë mësimin edhe më tërheqës

- Në çdo stacion vendos nga një lloj ushqimi nga ai shtet që ta provojnë nxënësit.
- Zbukuroje secilin prej stacioneve me elementë të veçantë nga shteti. Ja disa ide:
  - Vendos flamurin e shtetit.
  - Printo një foto të kafshës apo shpendit kombëtar.
  - Printo një foto të një zone të famshme në atë shtet.

Mësimi:

Çfarë dua të them kur them se po lutem me besim? *Nxiti nxënësit të përgjigjen.* Lutja është bashkëbisedimi ynë me Perëndinë. A na dëgjon Perëndia kur lutemi? (Po) A i interesojnë Perëndisë lutjet tona? (Po!) *Shih Hebrenjve 4:16 dhe 1 e Gjonit 5:14.* Ne e dime se Perëndia i dëgjon lutjet tona dhe interesohet për to. Gjithashtu e dime se Ai do t'u përgjigjet kërkesave tona me po, jo dhe prit. Ne mund të shkojmë para Perëndisë me siguri kur lutemi.

Sot do të kemi mundësinë të mundësinë të lutemi për vëllezërit dhe motrat e krishterë në Amerikën latine. A e dini se kur bëhesh i krishterë i bashkohesh familjes së madhe të Perëndisë? Nëse je i krishterë, ke vëllezër dhe motra në Krishtin kudo në botë! Si të krishterë, ne mund të lutemi për anëtarët e tjerë të familjes sonë të madhe. Ne e dime se Perëndia do t'i dëgjojë lutjet tona dhe se Ai interesohet për to. Lutjet tona kanë rëndësi!

Amerika latine është një rajon i madh dhe përfshin shumë shtete dhe shumë grupshtete: Meksika, Amerika qendrore, disa ishuj Karaibe dhe kontinenti i Amerikës jugore. A mund ta gjeni kontinentin e Amerikës jugore në hartë?

A e di ndonjëri prej jush ndryshimin mes një shteti dhe një kontinenti? *Nxiti nxënësit të përgjigjen.* Një kontinent është një hapësirë e madhe toke që përfshin disa shtete. Bota ka shtatë kontinente. Le t'i shohim të gjitha në hartën e botës. Në cilin kontinent jetojmë ne? *Kërkoju nxënësve të gjejnë kontinentin tuaj në hartë.*

A jetojmë ne në kontinentin e Amerikës jugore? *Nëse jo, pyeti:* A është kontinenti i Amerikës jugore afër apo larg nesh? *Nxiti nxënësit të përgjigjen.*

Do të lutemi për disa shtete specifike brenda rajonit të Amerikës latine. Në secilin prej këtyre shteteve ka kisha që përdorin programin e Zbuluesit, duke ndihmuar mijëra fëmijë të mësojnë për Jezusin. Në Amerikën latine programi Zbuluesit quhet Descubrelo. Le të mësojmë për këto shtete!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Duke përdorur vijëzimin e madh të Amerikës latine, prezanto shkurtimisht shtetet e mëposhtme, trego fotot korresponduese dhe kërkoju katër drejtuesve të qëndrojnë te secili prej stacioneve të lutjes dhe t'i ndihmojnë nxënësit të lexojnë pikat e lutjeve. (Nxënësit e vegjël do të lëvizin në grupe me një drejtues; shih më poshtë për të gjetur detaje)

Shteti 1: Uruguai
Në Uruguai ka dy kisha që përdorin programin Decubrelo. Në këto dy kisha ka rreth 20 drejtues dhe 150 fëmijë! *Trego foton.*
Kërkesa lutjesh:

- Lutuni që më shumë kisha të dëgjojnë për programin Descúbrelo. Kërkojini Perëndisë të sjellë drejtues që i duan fëmijët dhe duan t'i ndihmojnë ata të njohin Jezusin.
- Lutuni që fëmijët në Uruguai të mësojnë për Perëndinë kur janë të vegjël dhe të dine se sa shumë i do Ai.
- Lutuni që fëmijët në Uruguai të jenë të sigurt, të mbrojtur, të dashur dhe të përkujdesur në shtëpi dhe në shkollë. Kërkoji Perëndisë t'i mbajë mendjet e tyre të përqendruara te Jezusit dhe trupat e tyre të shëndetshëm.

Shteti 2: Kolumbia
Ka mbi 120 kisha në Kolumbi që përdorin programin Descubrelo. Ata po arrijnë mbi 6450 fëmijë e mbi 1000 drejtues! *Trego foton.*
Kërkesa lutjesh:

- Lutuni që më tepër kisha të duan t'u mësojnë fëmijëve për Jezusin!
- Lutuni që shumë fëmijë në Kolumbi të dëgjojnë Lajmin e Mirë për Jezusin dhe të besojnë tek Ai si Shpëtimtar.

Shteti 3: El Salvadori
Ka mbi 70 kisha në El Salvador që përdorin programin Descubrelo! Ata po arrijnë mbi 3500 fëmijë dhe mbi 430 drejtues! *Trego foton.*
Kërkesa lutjesh:

- Lutuni që prindërit në El Salvador t'i sjellin fëmijët (dhe miqtë e tyre!) çdo javë në kishë, në mënyrë që më tepër fëmijë të mund të dëgjojnë Lajmin e Mirë të Jezusit.
- Lutuni për fëmijët që kanë prindërit në burg. Kërkojini Perëndisë të kujdeset për ta dhe që ata të mund të kuptojnë se Ai i do.
- Lutuni për force dhe kurajë për drejtuesit e programit Descubrelo në El Salvador ndërsa shërbejnë me fëmijët dhe shpallin Ungjillin. Kërkoji Perëndisë t'i ndihmojë të arrijnë më tepër fëmijë dhe familje.

Shteti 4: Ekuadori
Ka 210 kisha në Ekuador që përdorin programin Descubrelo! Ata arrijnë mbi 10.500 fëmijë dhe mbi 1.300 drejtues! *Trego foton.*
Kërkesa lutjesh:

- Lutuni që më shumë njerëz të duan t'u mësojnë fëmijëve për Jezusin. Kërkojini Perëndisë të sjellë udhëheqës të forte që do të ndihmojnë me rritjen e programit Descubrelo në Ekuador.
- Lutuni që më shumë kisha në Ekuador të dëgjojnë për programin Descubrelo dhe të duan t'i ndihmojnë fëmijët që të dëgjojnë për Jezusin e ta ndjekin Atë.

Tani që keni mësuar për secilin prej këtyre shteteve, është koha të lunteni!
Udhëzoji fillimisht nxënësit, pastaj lutuni.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

- **Udhëzime për nxënësit e vegjël:** Ndaji nxënësit në grupe me nga 3-5 persona dhe cakto një drejtues në çdo grup. Drejtuesit do të shoqërojnë grupet e tyre në çdo stacion, do të mbledhin kartonët e vegjël me pikat e lutjes dhe pastaj do të luten për shtetin specifik sipas kërkesave të lutjes. Pasi të jeni lutur për çdo shtet, nxënësit duhet të kthehen te vijëzimi i hartës dhe të firmosin pranë shtetit në hartë. Kur të luhet muzika grupet duhet të kalojnë në stacionin tjetër. Shënim: Ndoshta për disa nga nxënësit duhet ta modelosh lutjen për një kërkesë specifike.
- **Udhëzimet për nxënësit më të rritur:** Nxënësit mund ta plotësojnë këtë veprimtari individualisht ose me partner. Ata duhet të vizitojnë secilin prej katër stacioneve, të marrin një nga kartonët e vegjël të lutjeve dhe të luten për secilin prej shteteve sipas kërkesave që gjejnë aty. Pasi të jenë lutur për secilin shtet, duhet të kthehen te vijëzimi i hartës dhe të shënojnë emrin e tyre pranë shtetit në hartë. Kur të luhet muzika, nxënësit duhet të kalojnë te stacioni tjetër.

Pasi të kenë kaluar 5-10 minuta, mblidhi nxënësit në një grup të madh dhe përfundoje kohën me lutje. Inkurajoji nxënësit t'i mbajnë kartonët e vegjël me pikat e lutjeve që të vazhdojnë të luten gjatë javës për ato kërkersa.

Kur ta kenë përfunduar të gjithë mësimin e misionit dhe të kenë shënuar emrat e tyre, vare banerin në një vend të dukshëm, që nxënësit të vazhdojnë të luten për Amerikën latine.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association